



Bashkia Pustec

Buxheti për Qytetarin

Plani 2022 - 2024

Shënim i rëndësishëm

Dokumenti bazohet në buxhetin e miratuar për vitin 2022 dhe programin buxhetor për periudhën 2022–2024 të cilat janë pjesë e Planit të performancës 2022 – 2024 të bashkisë Pustec.

<https://public.tableau.com/app/profile/loren5044/viz/Pustec-Planiiperformancs2022-2024/Tedhenatadministrative>

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Pustec me mbështetjen e Projektit Bashki të Forta dhe Kompania e konsulencës Shapo Consulting.

Përmbajtja

Fjalor shpjegues	3
Të dhëna të përgjithshme	4
Çfarë është buxheti për qytetarin.....	5
Nga vijtë paratë	5
Ku shkojnë paratë.....	7
Shpenzimet buxhetore	8
Investimet.....	9
Administrimi i bashkisë.....	11
Zhvillimi i turizmit.....	13
Mbrojtja zjarri dhe mbrojtja civile.....	15
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	17
Furnizimi me ujë.....	20

Fjalor shpjegues

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mbliidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Tasat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transferrat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transferrat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transferrat specifike

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

Nocione dhe mënyra e llogaritjes së disa treguesve të përdorur në këtë raport

Tregues të performancës së programeve buxhetore. Ndryshe treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin e saj. Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të buxhetit të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga QQ) si përshembull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullosor, rritja e frekuentimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj.

Shenja të përdorura në raport dhe leximi i tyre

Përmirësim



Përkeqësim



E njëjta situatë



Nuk ka informacion



Të dhëna të përgjithshme

Bashkia Pustec

Popullsia
5,175

1 Njësi

Sipërfaqe
198.7 km²

Bashkia Pustec e pozicionuar në lindje të vendit ka në përbërje vetëm një Njësi Administrative (me 9 fshatra: Pustec , Shulin, Leska, Zarashka, Cerje, Goricë e Madhe, Goricë e Vogël, Diellas, Gollomboc) me sipërfaqe prej 198.7 km². Pusteci ka 5,175 banorë sipas sipas Regjistrimit Civil. Kryeqendra e Bashkisë është fshati Pustec.

Bashkia ka rreth 1,000 familje, me një raport gjinor 49% femra dhe 51% meshkuj.

Rrjeti rrugor prej 22 km linear shtrihet në rreth 10 km në pjesën urbane të saj. .

Bashkia ka rreth 82 punonjës dhe drejtohet nga Kryetari **Pali Kolevski**.

Zhvillimi i përgjithshëm i bashkisë mbështetet në dy drejtime kryesore:

- ✘ Bujqësia dhe turizmi malor
- ✘ Promovimi i klimës së mirë për shëndetin

Bashkia si gjithë pjesa tjetër e vendit ka ndjerë efektet e pandemisë botërore. Fokusi për tre vitet e ardhshme mbetet:

- ✘ Mbrojtja e shtresave në nevojë
- ✘ Mbështetjen e biznesit për të kapërcyer efektet e pandemisë

Çfarë është buxheti për qytetarin

Buxheti për qytetarin promovon aksesin publik në informacionin buxhetor dhe ndihmon në miratimin e një buxheti të përgjegjshëm. Është konceptuar në mënyrë të thjeshtë për të shpjeguar sesi bashkia grumbullon, shpërndan dhe shpenzon paratë e tatimpaguesve.

Ky dokument tregon se çfarë ofron buxheti jo vetëm në shifra financiare por edhe se çfarë shërbimesh i ofrohen qytetarëve dhe cila është performanca e planifikuar për tre vitet e ardhshme.

Në këtë dokument janë paraqitur vetëm ato shërbime që zënë peshën më të madhe në buxhetin e bashkisë dhe ato që kanë rritjen më të madhe për vitin 2022 kundrejt vitit 2021.

Nga vijnë paratë


Burimet kryesore




Më poshtë burimet e shpërndarjes së parave do të vijnë në formë më të detajuar me taksa, të ardhura dhe tepricat që mbartim nga viti i shkuar. Rënia në totalin e burimeve të financimit reflekton rënien e kontributit të transfertës së kushtëzuar të qeverisë qendrore krahasimisht me vitin 2021 (me rreth 63%). Në tërësi të ardhurat nga burimet e veta të bashkisë prej taksave, tarifave vendore janë parashikuar në të njëjtin nivel me ato të vitit 2021 si për vitin 2022 ashtu edhe për gjithë periudhën tre vjecare.

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (000 Lekë)	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Ndryshimi në % 2022 vs 2021
	80,967	82,570	242,110	81,767	101,838	97,246	-60%

Kategoria	Burimi buxhetor							
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga taksat e ndara	369	42	500	510	520	531	2%
	Të ardhura nga taksat lokale	2,304	1,121	3,414	3,482	3,552	3,623	2%
	Të ardhura nga tarifa vendore	1,117	915	3,556	3,627	3,700	3,774	2%
	Të ardhurat e tjera	189	1,991	24,510	24,520	24,520	24,560	0%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e kushtëzuar	1,166		120,789	5,590	7,434	0	-95%
	Transferta e pakushtëzuar	33,765	34,566	35,257	36,255	35,433	38,080	0%
	Transferta specifike	18,063	23,508	26,679	26,679	26,679	26,679	0%
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi nga viti kaluar	24,003	20,427	27,405		0	0	-100%



Ku shkojnë paratë




Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2022 planifikohet të ulen kundrejt vitit 2021 duke reflektuar kështu rënien në burimet e financimit. Shërbimet më të financuar të bashkisë janë, administrata, arsimit bazë dhe parashkollor, turizmi, mbrojtja nga zjarri dhe furnizimi me ujë të pijshëm.

Dukshëm buxheti i vitit të ardhshëm është buxheti i mbështetjes së turizmit.

SHPENZIMET (000 Lekë)	Fakt	Fakt	Plan	Plan	Plan	Plan	Ndryshimi në %
	2019	2020	2021	2022	2023	2024	
	80,176	94,994	242,110	81,767	101,838	97,246	-60%

Shpenzimet buxhetore



Buxheti për vitin 2022 ulet me rreth 60% kundrejt vitit 2021 në të njëjtën vlerë me uljen e burimeve të financimit (projektet me financim të qeverisë).


Të gjitha shërbimet që ofron bashkia do të kenë një buxhet në rënie. Rënie më të madhe e ka shërbimi i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave si edhe ai për menaxhimin e rrjetit të kanaleve kulluese dhe vaditëse, dy shërbime këto të financuara me transfertat specifike të qeverisë qendrore.




Investimet

Cilat janë programet që kanë
përfituar më tepër

INVESTIME



INVESTIMET (Në mijë Lekë)	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
	29,437	118,822	5,500	7,934	1,000



Dy fjalë mbi rezultatin e investimeve

Bashkia synon të investojë për përmirësimin e shërbimeve publike një fond modest prej 5.5 milionë Lekë në vitin 2022, ashtu sikurse është edhe gjithë buxheti i bashkisë. Kundrejt vitit 2021 investimet janë ulur shumë duke pasur parasysh se në vitin 2021 parashikoheshin shumë projekte me kontribut të qeverisë qendrore.

Për vitin e ardhshëm pesha e investimeve pritet të arrijë rreth 6% të totalit të shpenzimeve buxhetore dhe 94% shpenzime korente (paga; shpenzime për mirëmbajtje dhe operimi) një peshë fare modeste në strukturën e shpenzimeve të bashkisë.

Projektet e investimeve synojnë përmirësimin e shërbimeve si: furnizimi me ujë të pijshëm, dhe përmirësimi i kushteve të administratës së bashkisë etj.

Administrimi i bashkisë

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj Buxhetit në %	Ndryshimi 2022 vs 21
Plani 2022	38,805	39%	-23%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin

Figura 1: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korente dhe investim

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
→	Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në numer kundrejt vitit të kaluar)	0	0	0	0	0	0
→	Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	36.5	5.1	0	0	0	0

Produkte	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plani 2024
Ditë trajnimi në total	0	0	0	0	0	0
Numri total i personave të trajnuar	0	0	0	0	0	0

Të dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	2022 Plan	Plan 2023	Plan 2024
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	27	4	0	0	0	0
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë	0	0	0	0	0	0
Numri total i punonjësve të bashkisë	74	78	82	84	84	86
Numri total i punonjësve ne njesite shpenzuese	15	19	26	27	27	27
Numri total i punonjësve të administratës së bashkisë	59	59	56	57	57	59
Shpenzime korente ne mije leke	38,748	39,234	49,405	38,305	39,165	40,319
Shpenzime për investime ne mije leke	47	0	800	500	500	1,000

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia planifikon të realizojë shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në shumën rreth 39 milionë lekë. Administrata zë rreth 39% të buxhetit të bashkisë. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën përgjithshësisht janë të pakta, por aty regjistrohen edhe investime që synojnë të përmirësojnë shërbimet publike që ofron kjo administratë e bashkisë. Në vitin 2022 ato janë rreth 0.5 milionë lekë pothuajse në të njëjtin nivel sikurse në vitin 2021. Administrata e bashkisë synon të përmirësojë performancën e saj gjatë vitit 2022 e në tre vitet e ardhshme duke u reflektuar në:

- ✿ Përmirësimin e respektimit të kuadrit ligjor dhe rregulloret e administratës
- ✿ Rritjen e kapaciteteve profesionale të administratës. Rritje e numri mesatar të ditëve të trajnimit për një punonjës
- ✿ Ruajtjen e një administrate të qëndrueshme.

INVESTIMET	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Në mijë lekë					
Administrimi i bashkisë	0	800	500	500	1,000
Emërtimi i Projektit	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Rikonstrukcion zyrat PMNZSH		3,220			

Zhvillimi i turizmit

Plani 2022	Vlera në mijë Lekë 23.680	Pesha ndaj Buxhetit në % 24%	Ndryshimi 2022 vs 21 -3%
------------	-------------------------------------	--	------------------------------------

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Figura 2: Kategoritë e shpenzimeve për programin Zhvillimi i turizmit: korrente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e turizmit malor dhe atij të klimës së shëndetshme si burim i rëndësishëm për ekonominë e bashkisë Pustec.

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Buxheti alokuar për ngritjen e zyrës / ose përmirësimin e shërbimit të saj (Ndryshimi vjetor në %)			642	-3	0	0
Numri i personave të akomoduar në hotele (Ndryshimi vjetor në numer)	1,760	-4,320	4,510	195	201	0
Të ardhurat nga taksa e hoteleve kundrejt totalit të të ardhurave nga taksat vendore (Raporti në %)	0	0	0	0	0	0

Të dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Numri i personave të akomoduar në hotele	6,320	2,000	6,510	6,705	6,906	6,906
Të ardhura nga taksa e qëndrimit në hotel ne mije leke	0	0	0	0	0	0
Të ardhurat nga taksat vendore ne mije leke	2,304	1,121	3,414	3,482	3,552	3,623
Shpenzime për mbështetjen e turizmit ne mije leke	0	3,273	24,295	23,680	23,680	23,680

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia planifikon shpenzime për zbatimin e projekteve që kanë për qëllim rritjen ekonomike e turizmin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, si dhe zhvillimi dhe promovimi i turizmit në masën 24 milionë Lekë. Bashkia shpenzon rreth 23% të buxhetit për këtë shërbim. Bashkia synon të përmirësojë performancën e saj në këtë shërbim gjatë vitit 2022 e në tre vitet e ardhshme duke u reflektuar në:

- ✿ Rritjen e numrit të turistëve që frekuentojnë hotele në fshtatrat turistike të Pustecit
- ✿ Rritjen e të ardhurave nga ekonomia vendore e mbështetur në turizmin malor.

Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi 2022 vs 21
Plani 2022	18,427	18%	-32%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 3: Kategoritë e shpenzimeve për programin Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia garanton shërbimin zjarrfikës, parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri dhe përballimi i emergjencave të tjera që vinë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Dalja nga stacioni (ndryshimi në sekonda)	0	0	0	0	0	0
Kosto mesatare e një rasti të menaxhuar nga Stacioni MZSH (Mijë lekë për një rast)						
Mbulimi kostove të shërbimit MZSH nga të ardhurat e shërbimit (në %)	0	0	0	0	0	0



Numri i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit (ndryshimi vjetor në numër)	0	0	0	0	0	0
Numri i stacioneve funksionale të MZSH në bashki	1	1	1	1	1	1

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia planifikon shpenzime për funksionimin e njësisë zjarrfikëse dhe të shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit si edhe ofrimin e mbrojtjes civile në shumën 18.4 milionë lekë për vitin 2022. Bashkia do të shpenzojë rreth 18% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Bashkia synon të përmirësojnë performancën në këtë shërbim gjatë vitit 2022 e në tre vitet e ardhshme duke u reflektuar në:

- ✿ Rritjen e kapaciteteve të punonjësve të njësisë së mbrotjes nga zjarri dhe shpëtimi për ti ardhur më shpejt në ndihmë komunitetit në raste emergjence zjarri apo civile
- ✿ Menaxhimin e të gjitha rasteve të njoftuara nga popullata apo indentifikuara nga inspektimi në terren
- ✿ Në këto dy vite të vështira prej pandemisë punonjësit e njësisë i kanë ardhur në ndihmë komunitetit duke ndihmuar personat e moshuar në shtëpi, duke shpërndarë ndihma ekonomike etj.

Produkte	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Numri i stacioneve funksionale të MZSH që ka bashkia	1	1	1	1	1	1

Të dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Total shpenzime për MZSH ne mije leke	7,409	7,331	26,909	18,427	17,054	17,725
Të ardhurat nga tarifat për shërbimin ndaj të tretëve (pajisja me fikse zjarri, etj) ne mije leke	0	0	0	0	0	0
Shpenzime për investime ne mije leke	322	0	0	0	0	0

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Plani 2022	Vlera në mijë Lekë 8.338	Pesha ndaj buxhetit në % 8%	Ndryshimi 2022 vs 21 -34%
------------	------------------------------------	---------------------------------------	-------------------------------------

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi baze dhe parashkollor: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
→	Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç (në %)	71.43	71.43	71.43	71.43	71.43	71.43
→	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)	4.94	4.94	5.0	5.12	5.0	5.27
→	Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)	4.94	4.94	5.0	5.16	5.0	5.27
○	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Mijë Lekë/institucion)						

Produkte	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Numri klasave funksionale në sistemin parashkollor						
Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	18	18	18	18	18	18
Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë						

Të dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjeç	51	51	52	53	55	55
Femra						
Meshkuj						
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç	0	0	0	0	0	0
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç	76	71	71	73	74	77
Mësues në sistemin parashkollor						
Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	18	18	18	18	18	18
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë	8,896	5,328	12,640	8,338	8,488	8,888
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	105	89	89	90	93	95

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia planifikon shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në shumën rreth 8.3 milion lekë për vitin 2022. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtjeshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet të vogla në fonde kanë pasur realizim të vogël për shkak të rifokusimit në prioritetet e bashkisë përgjatë vitit 2020. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 8% të buxhetit të saj. Për vitin 2022 buxheti do të zvogëlohet në mënyrë të ndjeshme (rreth 34%). Bashkia synon të përmirësojë performancën e saj në këtë shërbim gjatë vitit 2022 e në tre vitet e ardhshme duke u reflektuar në:

- ✿ Ruajtjen e nivelit të frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë;
- ✿ Ruajtjen e normës mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues edhe pse numri i nxënësve që frekuentojnë këtë sistem arsimor është rritur, nëpërmjet rritjes së numrit të mësuesve.

INVESTIMET	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Ne mije leke					
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	7,581	0			
Emërtimi i Projektit	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Rikonstruksioni i shkolles së Mesme Pustec	14,904	7,581			

Furnizimi me ujë

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi 2022 vs 21
Plani 2022	5,000	5%	95%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Furnizimi me ujë: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda në qytet dhe gjithë njësitë administrative të bashkisë.

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Orë ujë në ditë (Ndryshimi ditor në orë)	0	0	0	0.40	0	0
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm kundrejt popullsisë totale të bashkisë (në %)	47.25	47.25	48.66	50.12	52.00	51.63



Të ardhura kundrejt shpenzimeve totale (përfshire investime dhe amortizimi) (në %)	42.30	42.30	45.00	50.00	55.00	42.30
--	-------	-------	-------	-------	-------	-------

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

- ✿ Bashkia planifikon shpenzime për ofrimin e shërbimit me ujë të pijshëm dhe gjithë administrimin e problemeve të furnizimit me ujë, duke siguruar pastërtinë e ujit, çmimin e përbullueshëm dhe sasinë e nevojshme për familjet dhe bizneset në të gjithë bashkinë në shumën 5 milionë lekë për vitin 2022 të cilat do të shkojë për investime. Bashkia do të shpenzojë rreth 5% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Përgjatë viteve të kaluara ashtu edhe në vitet në vijim do të vazhdojnë investimet për ngritjen dhe vënien në funksionim të kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë duke përmirësuar performancën e këtij shërbimi që reflektohet në:
- ✿ Më shumë familje kanë akses në ujin e pijshëm pavarësisht nëse ato janë afër qendrës së bashkisë apo jo
- ✿ Rritja e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të pijshëm për banorët nga mesatarisht 8 orë në 9 orë
- ✿ Mbulimi i kostos së prodhimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm nga tarifat e shërbimit.

Produkte	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm (banorë)	2,445	2,445	2,518	2,594	2,672	2,672
Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm ne ore	8	8	8	9	9	9

Të dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Popullsia totale e bashkisë	5,175	5,175	5,175	5,175	5,175	5,175
Të ardhurat nga tarifa e ujit të pijshëm ne leke	0	0	0	0	0	0
Total shpenzime operative dhe mirëmbajtje për shërbimin ujit të pijshëm ne leke	0	0	0	0	0	0
Kosto totale për shërbimin e ujit të pijshëm (+ investime dhe amortizimi) ne leke	0	15,534	109,257	5,000	7,434	0

INVESTIMET	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Në mijë lekë					
Furnizimi me ujë	15,534	109,257	5,000	7,434	0
Emërtimi i Projektit	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024

Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi 2022 vs 21
Plani 2022	2.869	3%	-44%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Figura 6: Kategoritë e shpenzimeve për programin Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Mbështetja e prodhimit bujqësor dhe aktivitetit të fermerëve nëpërmjet menaxhimit të infrastrukturës sekondare dhe terciare të kanaleve kulluese dhe vaditëse.

Trendi

-
-
-

Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Numri i familjeve përfituese të shërbimit të vaditjes dhe kullimit (Ndryshimi vjetor në numër)						
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim (Ndryshimi vjetor në ha)						
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje (Ndryshimi vjetor në ha)						

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia planifikon shpenzime për ndërtimin dhe organizimin e sistemeve të kontrollit të përmytjeve, menaxhimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, nën përgjegjësinë e bashkinë në të gjitha njësitë administrative të saj në shumën 2.9 milionë lekë për vitin 2022. Bashkia do të shpenzojë rreth 3% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Ky shërbim është mjaft i rëndësishëm për komunitetin pasi ekonomia vendore varet nga bujqësia dhe turizmi. Bashkia synon të përmirësojë performancën në këtë shërbim gjatë vitit 2022 e në tre vitet e ardhshme duke u reflektuar në:

- ✿ Bërjen funksionale të kanaleve kulluese dhe vaditëse – pastrimin e mëtejshëm të tyre
- ✿ Rritjen e sipërfaqes bujqësore të mbuluar me shërbimin e vaditjes dhe kullimit
- ✿ Uljen e kostos së pastrimit të një kilometri linear kanal kullues dhe vaditës duke rritur eficiencën e përdorimit të parasë publike për këtë shërbim të ofruar nga bashki.
- ✿ Të dhënat e shërbimit mungojnë por në raportimet e ardhshme bashkia do të ofrojë informacion të detajuar në lidhje me performancën e shërbimit.

Produkte	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje ne ha						
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim ne ha						
Familje përfituese nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit						
Kanal kullues i pastruar ne km linear						
Kanal ujitës i pastruar ne km linear						
Sipërfaqe e tokës së kultivuar ne ha						

Të dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Buxheti i shpenzuar për ujitje dhe kullim (total shpenzime)	3,440	2,148	5,165	2,869	2,869	2,869
Shpenzimet për investime ne mije leke	910	0	0	0	0	0
Sistemi kullues ne km linear						
Sistemi ujitës ne km linear						
Sipërfaqe e tokës bujqësore ne ha						